

VENDIM
Nr. 66/2016

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR PËRDORIMIN DHE ADMINISTRIMIN NGA STRUKTURAT E MINISTRISË SË BRENDSHME DHE POLICISË SË SHETIT TË PAJISJES PËRGJUESE “IMSI CATHCER” DHE REALIZIMIN NËPËRMJET SAJ TË PËRGJIMEVE TË PALIGJSHME

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të katërtës së deputetëve, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për përdorimin dhe administrimin nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit të pajisjes përgjuese “IMSI Cathcer” dhe realizimin nëpërmjet saj të përgjimeve të paligjshme, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësi konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit në fuqi për hyrjen, administrimin dhe përdorimin e pajisjes përgjuese “IMSI Cathcher”.

2. Njohja dhe verifikimi i mënyrës së përdorimit të saj dhe lëvizjes së kryer nga kjo pajisje dhe mjetit ku ajo ndodhej.

3. Njohja me dokumentacionin e plotë ligjor për përdorimin e saj dhe veprimtarinë e kryer me pajisjen “IMSI Cathcher”, për të konkluduar në realizimin apo jo të përgjimeve të paligjshme nëpërmjet saj.

4. Kontrolli i sjelljes dhe veprimeve konkrete të autoriteteve të përfshira në këtë ngjarje, në raport me nevojën e zbardhjes së këtij skandali.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësi institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 9 deputetë, si më poshtë:

- | | | | |
|----|----------------|-----------------|-------|
| 1. | Flamur Noka | - Kryetar | (PD) |
| 2. | Pjerin Ndreu | Zëvendëskryetar | (PS) |
| 3. | Piro Lutaj | Anëtar | (PS) |
| 4. | Paulin Sterkaj | Anëtar | (PS) |
| 5. | Xhemal Qefalia | Anëtar | (PS) |
| 6. | Luan Rama | Anëtar | (LSI) |
| 7. | Keltis Kruja | Anëtar | |

- | | | | |
|----|----------------|--------|------|
| 8. | Asllan Dogjani | Anëtar | (PD) |
| 9. | Alban Zeneli | Anëtar | (PD) |

(PD)

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 4-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 6.10.2016